



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 nëntor 2021
Nr.ref.: RK 1907/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI157/21

Parashtrues

Nexhat Veseli

Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjkimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 296/2020, të 26 marsit 2021

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Nexhat Veseli, me vendbanim në fshatin Kufcë e Epërme, Novobërdë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi [Rev. nr. 296/2020] i Gjykatës Supreme, i 26 marsit 2021.
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e lartcekur e ka pranuar më 30 prill 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 26 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), e cila në Gjykatë u regjistrua më 30 gusht 2021.
7. Më 1 shtator 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Radomir Laban dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
8. Më 9 shtator 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi edhe Gjykatën Themelore në Gjilan për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
9. Më 21 shtator 2021, Gjykata Themelore në Gjilan dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.
10. Më 10 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

11. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës kishte lidhur Kontratë të punës me kohëzgjatje të caktuar, respektivisht nga 1 janari 2009 deri më 31 dhjetor

2009 me McCroft Tobacco Kosova LLC, nga Gjilani (në tekstin e mëtejshëm: punëdhënësi).

12. Më 27 maj 2015, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Gjilan, kundër punëdhënësit, duke pretenduar se ky i fundit e kishte larguar nga puna parashtruesin e kërkesës, tre muaj pasi kishte filluar punën dhe pa asnjë paralajmërim. Parashtruesi i kërkesës, përmes padisë drejtuar Gjykatës Themelore në Gjilan, kërkonte pagesën e 9 (nëntë) pagave mujore në vlerë prej 3.1500, 00 euro të cilat nuk i kishte realizuar nga punëdhënësi si rezultat i largimit nga puna.
13. Më 22 shkurt 2016, Gjykata Themelore në Gjilan, përmes Aktgjykimit [C. nr. 313/2016] vendosi si në vijim: (i) refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës, si dhe (ii) vendosi që secila palë t'i bartë për vete shpenzimet e procedurës kontestimore. Gjykata Themelore në Gjilan në arsyetim të Aktgjykimit të saj theksoi se punëdhënësi kishte falimentuar, dhe se ky i fundit i kishte paguar të gjithë punëtorët për periudhën sa kishin punuar, dhe pas muajit prill të vitit 2009, si rezultat i falimentimit nuk ishte paguar asnjë punëtor.
14. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
15. Më 12 dhjetor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 1654/16] vendosi si në vijim: (i) aprovoi si të bazuar padinë e parashtruesit të kërkesës duke e ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan; (ii) detyroi punëdhënësin që të paguajë shumën e përgjithshme prej 3.150, 00 euro parashtruesit të kërkesës në emër të pagave të papaguara për periudhën prill-dhjetor 2009 me kamatë ligjore sikurse për mjetet e deponuara në bankat komerciale pa destinim të caktuar; dhe (iii) secila palë i bartë për vete shpenzimet procedurale. Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj theksoi se gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore, gjendjen faktike e kishte vërtetuar drejtë, mirëpo sipas gjendjes faktike të vërtetuar, rezulton se gabimisht ishte zbatuar e drejta materiale.
16. Në një datë të paspecifikuar, punëdhënësi kishte paraqitur revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
17. Më 26 mars 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 296/2020] aprovoi si të bazuar revizionin e ushtruar nga punëdhënësi dhe e la në fuqi Aktgjykimin [C. nr. 313/2016] e Gjykatës Themelore në Gjilan, të 22 shkurtit 2016. Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj konsideroi se Aktgjykimi [C. nr. 313/2016] i Gjykatës Themelore në Gjilan, i 22 shkurtit 2016 ishte i drejtë dhe i ligjshëm, përderisa Aktgjykimi [Ac. nr. 1654/16] i Gjykatës së Apelit ishte i përfshirë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
18. Më tutje, në aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Supreme theksohet: *“me vet faktin se paditësit i është ndërprerë kontrata e punës, në mënyrë të njëanshme*

dhe për këtë nuk ka kërkuar mbrojtje përmes procedurave gjyqësore, për të vërtetuar faktin nëse ndërprerja e marrëdhënies ishte e paligjshme, ai nuk mund të kërkojë përmbushjen e kontratës, siç ka kërkuar përmes kërkesëpadisë, objekt i kësaj çështjeje, pasi realisht kontrata me shkëputjen e njëanshme të njëres palë është in ekzistente, dhe pala tjetër mund të kërkojë vetëm dëmin e shkaktuar si rezultat i ndërprerjes së njëanshme në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe dispozitave ligjore, kjo rrethanë është e përcaktuar me nenin 132 të LMD-së”.

19. Më 31 maj 2021, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë pranë Zyrës së Prokurorit të Shtetit, kundër Aktgjykimit [C. nr. 313/2016] të Gjykatës Themelore në Gjiilan, të 22 shkurtit 2016 si dhe Aktgjykimit [Rev. nr. 296/2020] të Gjykatës Supreme të 26 marsit 2021.
20. Më 7 korrik 2021, Zyra e Prokurorit të Shtetit, përmes Njoftimit [KMLC. nr. 68/2021] refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, me arsyetimin se nuk ka bazë ligjore, pasi që bazuar në nenin 254 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të parashtrohet vetëm kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
22. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij vetëm ka cekur nenet e lartpërmendura të Kushtetutës, duke mos elaboruar më tutje se si të njëjtit me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore.
23. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shfuqizojë vendimin e kontestuar, respektivisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, dhe të lërë në fuqi Aktgjykimin [Ac. nr. 1654/16] e Gjykatës së Apelit të 12 dhjetorit 2019.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

24. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

26. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

27. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 296/2020] e 26 marsit 2021 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Në këtë aspekt, kërkesa e parashtruesit të kërkesës është në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
28. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (1) (d) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (1) (d) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (1) (d) në veçanti përcakton që:

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(1) (d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese".

29. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një Kontratë pune të lidhur në vitin 2009 në mes të parashtruesit të kërkesës dhe punëdhënësit. Më pas, pas periudhës tremujore që nga koha e lidhjes së kontratës, rezulton se punëdhënësi e kishte larguar nga puna parashtruesin e kërkesës. Ky i fundit kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore kundër punëdhënësit, duke kërkuar pagesën edhe të 9 pagave të tjera, respektivisht pagat nga muaji prill deri në dhjetor të vitit 2009. Gjykata Themelore refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se punëdhënësi kishte falimentuar. Më pas, pas ankesës së parashtruesit të kërkesës në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit aprovoi ankesën dhe e detyroi punëdhënësin që të paguajë pagat e porealizuara. Më pas, punëdhënësi parashtroi revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme e miratoi revizionin e ushtruar nga punëdhënësi dhe konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit ishte i përfshirë me shkelje esenciale të së drejtës materiale, dhe në këtë mënyrë la në fuqi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë te Prokurori i Shtetit, dhe ky i fundit e njoftoi parashtruesin e kërkesës se nuk kishte bazë ligjore, pasi që bazuar në nenin 254 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të parashtrohet vetëm kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë.
30. Këto konstatime parashtruesi i kërkesës i konteston para Gjykatës, duke pretenduar se përmes vendimit të kontestuar janë shkelur të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë, respektivisht me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
31. Gjykata, bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, vlerëson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë pretendime të pambështetura apo paarsyetuara. Kjo sepse, parashtruesi i kërkesës vetëm ka përmendur shkeljen e neneve të Kushtetutës, duke mos ofruar asnjë arsyetim dhe duke mos mbështetur pretendimet e tij rreth mënyrës se si Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, përfshirë edhe vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët, mund të kenë rezultuar në shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë, respektivisht me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
32. Gjykata, gjithashtu, rikujton se ajo vazhdimisht ka theksuar se vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut (shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës K102/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019,

paragrafi 36; dhe KI95/19, parashtues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31).

33. Gjkata, gjithashtu rikujton se, duke u bazuar në nenin 48 të Ligjit dhe paragrafët (1) (d) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe praktikën e saj gjyqësore, ajo vazhdimisht ka theksuar se: (i) palët kanë detyrim që të qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqesin faktet dhe pretendimet; dhe gjithashtu (ii) të dëshmojnë dhe në mënyrë të mjaftueshme të mbështesin pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.
34. Gjkata konstaton se kërkesa e parashtuesit të kërkesës është e papranueshme si, siç është përcaktuar përmes nenit 48 të Ligjit për Gjykatë Kushtetuese dhe paragrafit (1) (d) të rregullit 39 të Rregullores së punës

PËR KËTO ARSYE

Gjkata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (d) të Rregullores së punës, më 10 nëntor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani